



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 142/ Prot
3

Tiranë, më 11 / 03 / 2015

REKOMANDIM

Nr. 11 datë 11 / 03 2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar në ngarkim të kontrolluesit **Bashkia Lezhë**,

KONSTATOVA:

Pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është paraqitur ankesa e shtetasit me iniciale (Gj.F). Ky shtetas i është drejtuar zyrës së Komisionerit me ankesë ku pretendon se, në faqen e internetit www.lezha.gov.al, të Bashkisë Lezhë, janë publikuar të dhëna personale në kundërshtim me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të personave që përfitojnë ndihmë ekonomike, nxënës që marrin bursë, shërbime të tjera që u kryen qytetarëve.

Në kuadër të bashkëpunimit dhe zgjidhjes së ankesës, zyra e Komisionerit i është drejtuar kontrolluesit, Bashkia Lezhë me shkresën Nr. 142/1 Prot, datë 11.02.2015, nëpërmjet së cilës u kërkua informacion lidhur me bazën ligjore të kontrolluesit për publikimin e listave të kategorive të subjekteve të të dhënave që përpunohen, qëllimin e publikimit, sasinë e informacionit të publikuar në faqen e tij të internetit.

Në përgjigjen e kthyer me shkresën Nr. 803/1 Prot, datë 23.02.2015, Bashkia Lezhë ka paraqitur sqarime, ku është shprehur se, *publikimi i vendimit të Këshillit të Bashkisë për akordimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimet shoqërore, ndaj familjeve dhe personave në nevojë, jo vetëm që nuk është konsideruar nga jonë si e dhënë personale, por si një detyrë ligjore dhe transparencë në menaxhimin e fondeve buxhetore që shteti shqiptar vë në dispozicion të këtij kontigjenti në nevojë.*

Publikimi i vendimit të Këshillit të Bashkisë për miratimin e listës së përfituesve të ndihmës ekonomike dhe pagesën për personat me aftësi të kufizuar, bazohet në ligjin nr. 47/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore të ndryshuar", neni 6 pika 1 " Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore publikon, brenda 24 orëve nga marrja e vendimit, listën e plotë të përfituesve të ndihmës ekonomike dhe pagesën për pesonat me aftësi të kufizuar".

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e kontrolluesit në kuadrin e dhënies së informacionit në lidhje me rastin konkret. Pas shqyrtimit të parashtrimeve dhe verifikimeve të mëtejshme, pretendimi që të dhënat e publikuara nuk janë të dhëna personale, është i gabuar. Duhet patur parasysh pika 1 e nenit 3, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të

Dhënave Personale”, i ndryshuar, i cili shpjegon kuptimin e termit të dhënat personale “*Të dhëna personale*” është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

Në këtë kuptim, të dhënat e subjekteve të të dhënave të cilët janë përfitues të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore, nxënës që marrin bursë, personave në nevojë dhe familjeve të tyre, janë të dhëna personale. Për më tepër, të dhënat personale të personave me aftësi të kufizuara janë të dhëna të kategorisë sensitive, sipas përcaktimeve të nenit 3, pika 4 dhe nenit 7, të ligjit dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë.

Në lidhje me mbledhjen dhe publikimin e të dhënave personale në faqen e internetit, nga kontrolluesi, ky publikim bazohet në detyrimet që rrjedhin prej ligjit organik të tij, ligji nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar, neni 6 pika 1 “Këshilli i njësishë së qeverisjes vendore publikon, brenda 24 orëve nga marrja e vendimit, listën e plotë të përfituesve të ndihmës ekonomike dhe pagesën për pesonat me aftësi të kufizuara”.

Megjithatë, në çdo rast, çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, ka detyrimin për informim të publikut, subjekte të të dhënave personale. Ky detyrim rrjedh nga përcaktimet e nenit 18, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, “*Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t’i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij. Në rast se kontrolluesi përpunon të dhëna personale, të marra nga subjekti i të dhënave, ai është i detyruar të informojë subjektin e të dhënave nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare. Nëse subjekti i të dhënave, në bazë të një akti ligjor ose nënligjor, është i detyruar të japë të dhëna personale për përpunim, kontrolluesi e informon edhe rreth këtij fakti, si dhe rreth pasojave të refuzimit të dhënies së të dhënave personale”.*

Standartet që përcakton ligji, në nenin 5, 6 të tij apo nenet e tjera mbi përpunimin e të dhënave personale si saktësia e mbledhjes së informacionit, informimi, pëlqimi, mjaftueshmëria etj, i referohen jo vetëm trajtimit nga kontrolluesit të informacionit personal që nuk ka për qëllim të bëhet publik por, gjithashtu përcaktojnë standarte që së bashku lehtësojnë mbledhjen dhe trajtimin e duhur të informacionit që përmbajnë edhe baza të dhënash që kanë si qëllim bërjen të njohur ndaj publikut të gjerë të këtij informacioni.

Ndërkohë, Udhëzimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Nr. 39, datë 05/08/2013 “Për përpunimin e të dhënave personale në regjistrat publikë” është i detyrueshëm për zbatim nga të gjithë institucionet publike, të cilët në bazë të një akti ligjor ose nënligjor administrojnë dhe bëjnë publike të dhëna personale që përmbahen në një regjistër publik.

Pikat 12 dhe 13 të këtij udhëzimi parashikojnë se, “*Gjatë fazës së mbledhjes së informacionit drejtpërdrejtë nga subjektet e të dhënave personale për qëllime të përfshirjes rishtas në një regjistër publik, institucioni publik duhet të sigurohet që subjekteve t’u bëhet e qartë që*

informacioni i mbledhur do të përfshihet në një rregjistër i cili do të jetë i hapur për publikun.

a). Informimi që mbledhja e këtyre të dhënave do të përfshihet në një regjistër të hapur për publikun në bazë të detyrimi ligjor specifik duhet të përmbajë, informimin e subjekteve në lidhje me seksionin e ligjit ose aktin nënligjor specifik, qëllimin e mbledhjes, bërjes publike dhe informacion mbi pasojat e parashikuara nëse ky informacion nuk mblidhet.

Pika 13, "Koha e bërjes publike të të dhënave në regjistrin publik duhet të jetë e limituar përveç rasteve kur vetë ligji parashikon publikimin e tyre për një afat të pacaktuar. Në rastet e tjera informacioni duhet të jetë publik për aq sa është i nevojshëm informimi i publikut në lidhje me informacionin që përmbajnë këto regjistra në përputhje me qëllimin.

a). Në ato raste, kur ligji nuk shprehet për kohën e bërjes publike të të dhënave që përmban një regjistër atëherë është detyrë e kontrolluesit që të vlerësojë kohën e nevojshme për të lënë informacionin të hapur ndaj publikut. Kjo kohë nuk mund të jetë për një afat të pacaktuar".

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 5, 6, 7, 18, 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të Kodit Procedurave Administrative;

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, kontrolluesi Bashkia Lezhë, gjatë mbledhjes, përpunimit të dhënave personale, të realizojë informimin e subjekteve të të dhënave personale, nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të internetit www.lezha.gov.al, të bazës ligjore për publikimin e të dhënave personale të kategorive të subjekteve të të dhënave personale përfitues të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore, personave në nevojë dhe familjeve të tyre, qëllimin e publikimit dhe të drejtat e subjekteve. (Zyra e Komisionerit ofron ndihmën e saj në formulimin e rubrikës për informim).
2. Ky detyrim të plotësohet brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit të këtij rekomandimi.
3. Kontrolluesi, gjatë administrimit dhe publikimit të informacionit personal që përmbahet në vendimet e Këshillit të Bashkisë të respektojë kushtet e kriteret e përcaktuara në Udhëzimin Nr. 39, datë 05/08/2013 "Për përpunimin e të dhënave personale në regjistrat publikë", të Komisionerit.
4. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, me plotësimin e detyrimit sipas pikës 1, të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
5. Me kalimin e afatit të përcaktuar në pikën 2, në rast mos përmbushjeje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të mos zbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksione për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

